

VENDIM
Nr. 293, datë 17.5.2023

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN
2023, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE
MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në buxhetin e vitit 2023, në programin “Tregu i punës”, në artikullin 606, i pakësohet fondi prej 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekësh.
 2. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e vitit 2023, në programin “Zhvillimi i turizmit”, në artikullin 604, i shtohet fondi prej 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekësh për zhvillimin dhe promovimin e destinacioneve, produkteve dhe diversifikimin e ofertës turistike në turizëm.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku